REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1007/1 prot. Tiranë më 14. 6.2018

Lënda: Mbi ankimin ndaj vendimit të Këshillit Bashkiak Berat nr. 31, datë 19.03.2018

**KABLLOR "ILIRA"**
**TV KABLLOR LAPARDHA**
**KABLLOR "IRLA SH.P.K"**
**KABLLOR "FUTURE TELECOM"**
**KABLLOR "BERNET SH.P.K"**

**Berat**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1007 Prot., datë 08.06.2018, mbi "*Ankimin ndaj vendimit të Këshillit Bashkiak Berat nr.31, datë 19.03.2018*", sqarojmë se pas verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, ankesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën 1/b, të nenit 21, të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", në të cilin parashikohet se: "*Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cënuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të nenit 6, të këtij ligji si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen: b. Pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,* ***brenda 30 ditëve nga data e miratimit***".

Për sa më sipër, ankesa juaj nuk mund të shqyrtohet pasi ankimi adresuar pranë Zyrës së Komisionerit është në tejkalim të afatit të parashikuar në ligj.

**DREJTOR**

**Blerta Xhako**

Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tiranë", Telefon:00355 42237200, www.idp.al info@idp.al